

↑ KUSH JEMI NE – AGJENCIONI KOSOVAR PËR PRONA?

Agjencioni Kosovar për Prona (KPA) është themeluar më 4 mars 2006 si agjencion i pavarur me mandat të zgjidhë kërkesat mbi humbjen e pronësive mbi pronat private të patundshme si rrjedhë e konfliktit të armatosur të vitit 1999.

↑ ÇFARË LLOJ KËRKESASH MUND TË ZGJIDHË KPA-JA?

KPA-ja mund të zgjidhë kërkesat mbi humbjen e pronësive mbi pronën private të patundshme të cilat përfshijnë

- pronësinë; ose
- të drejtat e shfrytëzimit

që janë rrjedhë e konfliktit të armatosur të vitit 1999 dhe ku kërkuasi nuk mund të rikthejë vet pronësinë.

↑ ÇFARË LLOJ KËRKESASH KPA-JA NUK MUND TË ZGJIDHË:

Si pasojë e mandatit statutor të KPA-së, agjencioni nuk ka juridiksion mbi kërkesat për:

- Humbjen e posedimit mbi pronën e cila nuk është pasojë e konfliktit të armatosur të vitit 1999 (p.sh. nacionalizimi i mëparshëm);
- Pronë tjetër përpos asaj private (p.sh. ndërmarrje shoqërore dhe vjedhje të tundshmërie);
- Kompensim për dëmtim, shkatërrim ose shfrytëzim të pasautorizuar të pronës private - ose ndihmë në rindërtim;

SI TË BËHET KËRKESA?

1



Ju mund të bëni kërkesën personalisht, përmes ndonjë anëtare të familjes së ngushtë ose përfaqësuesi ligjor të autorizuar nëse ai ka Autorizim të plotfuqishëm. Për të bërë këtë, ju lutem kontaktoni zyrën tonë për praninë të kërkesave që të caktoni takim. Lokacioni dhe hollësitë për kontaktim të zyreve tona janë listuar në faqen e prapme të kësaj fletushke.

Kur të vini në zyrën tonë ju duhet të sillni me vete të gjitha dokumentet që posedoni ose që mund t'i merri dhe të cilat vërtetojnë ose mbështesin të drejtën tuaj pronësore. Edhe nëse nuk keni dokumente ju mund të bëni kërkesë dhe KPA-ja do të kërkojë ato në regjistrat publike të pronave.

2



3



Kur të vini në KPA një punonjës yni do të marrë hollësitë nga ju dhe do t'ju ndihmojë të bëni kërkesën. Nëse sillni dokumente, ne do të bëjmë fotokopimin e tyre dhe origjinali do t'ju kthehet juve menjëherë pasi që ne nuk mbajmë origjinalin. Ju lutem sigurohuni që të merri të gjitha dokumentet origjinale para se të lëshoni zyrën.

SI DO TË PËRPUNOHET LËNDA?

KPA-ja do të publikojë kërkesën tuaj dhe do të lejojë të tjerët që kanë interes ligjor mbi pronën të marrin pjesë në procedurë.

4



5



Kërkesa juaj do hulumtohet individualisht. Kjo përfshinë verifikimin e dokumenteve dhe hulumtimin në regjistrat publik të pronave.

Pas hulumtimit të plotë të kërkesës suaj ajo do t'i prezentohet Komisionit të Pavarur për Kërkesa Pronësore për vendim.

6



SI DO TË VENDOSËT PËR KËRKESËN?

7



Komisioni për Kërkesa Pronësore do të lëshojë vendim me të cilin pranon ose refuzon kërkesën tuaj. Nëse nuk pajtoheni me vendimin, keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.

Vendimet përfundimtare të Komisionit për Kërkesa Pronësore ose në rast të ankësës, vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, janë të detyrueshme dhe të imponueshme dhe nuk do të rishqyrtohen nga asnjë autoritet tjetër ligjor ose administrativ në Kosovë.

8



9



KPA-ja do të implementojë vendimin në përputhshmëri me kërkesën e palës.

www.kpaonline.org

**DOKUMENTET QË MBËSHITESIN
KERKESËN TUAJ MUND TË PËRFSHIJNË
ÇDONJËRËN PREJ KËTYRE**

- Kontrata e shitblerjes
- Flea poseduese
- Vendimi i gjykatës mbi përcaktimin e të drejtës pronësore
- Deklarata e nënshkruar nga ana e shitësit ose dëshmitarit
- Kopja e Planit Kadastral
- Certifikata Kadastrale ose dokumente tjera kadastrale
- Vendimi mbi Ndarjen
- Kontrata mbi Shfrytëzimin
- Marrëveshja mbi Qiranë
- Vendimi mbi Trashëgiminë në rast se pronari i pronës ka vdekur
- Faturat e komunalieve
- Të dhënat Tatimore
- Leja e përkohshme e lëshuar nga autoriteti publik ose pronari i pronës

ZYRET E KPA-SË GJENDEN NË

Beograd
Kosovska 48/8 Tel: 011 334 5513 or 224
5314 Fax: 011 334 4452

Gjilan
Rade Popovic/Washington Street
Tel: 0280 20 289 - fax: 0280 24 067

Kragujevc
9, "Ljolla Ribar" Rr. Kati 316
Tel: 034 330-234; 330-784

Mitrovicë
Pjesa jugore: rr. Mbrojtësia Teuta
(përbailë Jugobankës) 028 30 136 and
30137 - fax: 028 30 139
Pjesa Veriore: rr. Filip Vishnjik No. 4,
Dhoma No. 18 (ish Ndërtësa e AKM),
Stacioni Vënor i Policisë Tel: 053 197
6470 - fax: 028 30 139

Nish
rr. "Dusanov Bazar" (Dusanova) Kati 316,
Zryja No. 308
Tel: 018 515-727; 515-728

Pejë
rr. Bill Clinton, No. 54
Tel: 039 32 968 - fax: 039 32 970

Podgoricë
Cmogorskih Sendara
Tel: 081 624 216

Prishtinë
Qendër: Rexhep Luci 28/rr. Goleshit 2 Tel:
038 225 473 - fax: 038 244 854
Graçanicë: Prapa ndërtësës së komunës
Tel: 038 225 473

Prizren
Jeronim Derada (ish Zef Mark
Lushi/Metohisë) No. 63/A
Tel: 038 504 604 8046 - fax: 029 631 429

Shkup
rr. Vinicka No. 10 (ndërtësa CDRIM),
kati i 2e
Tel: +389 22 65 2291



**A KENI NDONJË PRONË PRIVATE
(P.SH. TOKË, BIZNES OSE
VENDBANIM) MBI TË CILËN KENI
HUMBUR PRONËSINË, SI
REZULTAT I KONFLIKTIT TË
ARMATOSUR NË KOSOVË?**

**NËSE PO, NDOSHTA NË MUND
T'JU NDIHMOJMË!**

kpa
Agjencioni Kosovar Për Prona